



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

VENDIM  
Nr. 17, datë 21.01.2021

PËR  
CAKTIMIN E GJYQTARËVE PËR GJYKIMIN E ÇËSHTJEVE GJYQËSORE TË  
VEÇANTA NË GJYKATA TË TJERA, TË NDRYSHME NGA AJO KU USHTROJNË  
FUNKSIONET NË MËNYRË TË PËRHERSHME

Këshilli i Lartë Gjyqësor bazuar në nenet 4/3, 147/1, 147/a, pika 1 germa “a” të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenet 2 e 89 të ligjit nr.115/2019 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” në vendimin nr.30, datë 14.02.2019 të Këshillit të Lartë të Gjyqësor që miratoi projektvendimin “Për rregullat dhe procedurat e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme” i ndryshuar, në rastet kur skema e delegimit dhe transferimi i përkohshëm janë të pamjaftueshme për t’iu përgjigjur nevojave aktuale të gjykatave, pasi shqyrtoi relacionin dhe propozimin e Komisionit për Zhvillimin e Karrierës si dhe organizoi shortin, në përfundim të tij,

**V E N D O S I :**

I. Të caktojë gjyqtarët për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykatat në nevojë si vijon:

**GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR TROPOJË**

1. Gjyqtarët e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës, Alma Ahmeti dhe Florin Demollari, caktohen në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tropojë, çështjen gjyqësore me Kërkues: {...}; Objekt: “Gjykimi i procedimit penal nr. {...}, viti 2018, në ngarkim të të pandehurit Nikë Lulashi, akuzuar për veprat penale “Vrasje me paramendim” dhe “Mbajtje pa leje dhe prodhim i armëve shpërthyesë dhe i municionit”, parashikuar nga nenet 78, 278/1 dhe 278/3 të Kodit Penal”.

**GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR MAT**

1. Gjyqtari i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër, Xhevdet Lika, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat, çështjen gjyqësore me Kërkues: {...}; Objekti: “Përfundim gjyqtari”.

2. Gjyqtari i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër, Ardit Kuka, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat, çështjen gjyqësore me Kërkues: Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat; I pandehur{...} {...}); Objekti: “Njohtë vendimi penal i huaj, parashikuar nga neni 152 i Kodit të Procedurës Penale” .

## **GJYKATA E POSAÇME E APELIT PËR KORRUPSIONIN DHE KRIMIN E ORGANIZUAR**

1. Gjyqtari i Gjykatës së Apelit Vlorë, Sokol Ngresi, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, çështjen penale me të pandehur: {...}, {...}, {...}, {...}; Akuza: “Nenet 283/a/1, 28/4, 333/a/1, 334/1 të Kodit Penal”.

II. Një kopje e vendimit t’i njoftohet kryetarit të gjykatës në nevojë dhe gjyqtarëve përkatës të caktuar për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në një gjykatë tjetër.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë me publikimin e tij në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

**PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR**